

rfundimit të luftës, më 2.10.1999, mbetjet e tij mortore janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në *Kodrën e Kuqe/ Crveni breg* në Grabanicë/Grabanica.

Burimet: J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Isuf (Azem) Hyseni

(21.07.1957, shqiptar nga Pluzhina/Pluzina, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtime, katër fëmijë)

Isufi me familje kanë jetuar në *Mëhallën Mehqi* në Pluzhinë/Pluzina [Skënderaj/Srbica]. Në datën **25.05.1998**, ai me djalin Mehdiun dhe vëllain Ruzhdiun u nisën për t'i kërkuar lopët e humbura në pyll. Arritën deri te aeroporti bujqësor në afërsi të **Jashanicës/Jošanica**. Aty u vunë re nga pjesëtarët e forcave serbe, që menjëherë hapën zjarr ndaj tyre. Përderisa Isufi ra në tokë, Mehdiu dhe Ruzhdiu nisën të vraponin, duke mos e hedhur shikimin prapa. Ditën tjetër, ata u kthyen në vendin e ngjarjes, ku e kishin lënë Isufin, por ai nuk ishte atje dhe as që kishte ndonjë gjurmë të tij. Trupi i tij nuk është gjetur as sot e kësaj dite. Familjarët e kanë paraqitur zhdukjen e Isufit te KNKK. Zhdukja e tij është regjistruar në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së me numër BLG-803034-01.

Burimet: deklarata V.H, FDH-14552; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.298.1.4, FDH-30924; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; SMIP, *Terroristički...*, III, 386.

Vitimir (Petar) Šćepanović

(11.12.1972, serb nga Shalinovica/Šaljnovica, komuna e Istogut/Istok, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Pas mbarimit të shkollës së mesme për punë të brendshme, Vitimiri, i quajtur Vitko, u punësua në Sekretariatën e Punëve të Brendshme të Klinës/Klina. Udhëtonte për ditë nga Shalinovica/Šaljnovica në punë në Klinë/Klina. Në datën **18.06.1998**, ai ishte në përcjellje të grupit të civilëve serbë që udhëtonin nga Klina për në Kijevë/Kijevo [Malishevë/Mališevo], ku u nisën për ta ushqyer bagëtinë e vet. Për shkak të përleshjeve të armatosura, këta civilë ishin larguar

një muaj më parë nga fshati i vet. Në kthim nga Kijeva/Kijevo, diku në seksionin e rrugës afër **Gllarevës/Iglarevo**, në mes të orës 13:00 dhe 14:00, kanë rënë në pritë të pjesëtarëve të UÇK-së. Vitimirin e kanë plagosur përderisa tentonte t'i ndihmonte një gruaje të moshuar, e cila ka rënë para tij. Ka ndërruar jetë nga plaga në rrugë për në spitalin e Pejës/Peć. Një ditë më vonë, më 19.06.1998, e kanë varrosur në varrezat e Shalinovicës/Šaljnovica.

Burimet: deklarata D.M, FDH-31796; deklarata D.Đ, FDH-31214; deklarata M.R, FDH-18928; SV SR], *Junaci otadžbine*, 75; SMIP, *Terroristički...*, III, 934; KKKMKRF], *Personat...*, FDH-10-832; Z. Stijović, *Kosmet...*, 110; *Dnevnik od 17. do 23. juna*, Ilustrovaná politika, jun 1998, FDH-18837.

Dragoljub (Trajko) Vošić

(2.12.1929, serb nga Jelloci/Jelovac, komuna e Klinës/Klina, pensionist)

Radomir (Milutin) Vošić

(3.04.1931, serb nga Jelloci/Jelovac, komuna e Klinës/Klina, murator, shtatë fëmijë)

Baballarët e Dragoljubit dhe Radomirit kanë qenë vëllezër. Në datën **20.06.1998**, ata dy dhe vëllai i Radomirit, Slobodani, kanë shkuar për ta kositur livadhin jashtë fshatit. Livadhi kufizohet me pronën e familjes Rraci [Jelloc/Jelovac]. Nga ora 10:00, bashkëshortja e Slobodanit u ka çuar kafjallin dhe, më pas, u kthye në shtëpi. Pas saj, edhe Slobodani u kthye në shtëpi. Dragoljubi dhe Radomiri mbetën për ta kryer punën. Ngase u vonuan dhe nuk erdhën deri në ora 14:00, bashkëshortja e Radomirit, Đurđa, ka shkuar për të parë nëse e kishin përfunduar kositjen. Në livadh i ka gjetur kosat, bluzat e tyre të varura në shkurre, madje edhe cigaret e tyre. Por ata mungonin [Jelloc/Jelovac]. Familjarët e kanë njoftuar menjëherë policinë për rastin. Afro dhjetë ditë më vonë, gratë e familjes Vošić kanë dëgjuar se pjesëtarë të UÇK-së i kanë zënë Dragoljubin dhe Radomirin dhe se, po atë ditë, i kanë çuar në fshat. I mbajtën të lidhur dhe me thasë në kokë. Pas dy apo tre orësh, i kanë çuar me veturë të tipit *Lada Niva* në drejtim të panjohur. Për fatin e Dragomirit dhe Radomirit nuk dihet asgjë